



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:007260
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05757985

C.nr.70/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit V.M. nga fshati S., Komuna e D., të cilin e përfaqëson F.B., avokat në Pejë, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike zhdëmtim nga autopërgjegjësia, vlera e kontestit 1000 euro, në seancën e datës 22.05.2024 mori, ndërsa me datën 30.05.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditësit V.M. nga fshati S., Komuna e D., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, e parashtruar me datë 21.01.2020, me bazë juridike zhdëmtim nga autopërgjegjësia, vlera e kontestit 1000 euro.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Arsyetim

Në këtë gjykatë, paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 21.01.2020, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S...”, me seli në Prishtinë, me bazë juridike zhdëmtim nga autopërgjegjësia, vlera e kontestit 1000 euro.

Gjykata, me datën 22.05.2024 ka caktuar seancën përgatitore, në të cilën nuk kanë prezantuar asnjëra palë në procedurë, edhe pse në shkresat e lëndës ka pasur prova se të njëjtit kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, përkatësisht nga fletëkthesat e kthyer gjykatës, ku shihet qartë se pala paditëse përkatësisht i autorizuari i tij ftesën për seancën e datës 21.05.2024 e ka pranuar me datën 25.04.2024, dhe po ashtu edhe pala e paditur ftesën e tillë e ka pranuar me datën 29.04.2024, por që në seancë nuk kanë prezantuar dhe mungesën e tyre nuk e kanë arsyetuar.

Sipas nenit 409 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se *“Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet në mungesë të paditësit”*. Prandaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe nga arsyet e lartcekurat rezultojnë

se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konsiderohet e tërhequr.

Gjykata në bazë të nenit 409 par.1, 387 par.1 e lidhur me nenin 450 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.70/20, me datë 30.05.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjete (15) ditëve, pas marrjes së të njëjtit, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.